

EVALDA PACI

MESHARI I BUZUKUT NË STUDIMET E CAMAJT DHE TË RIZËS (VËSHTRIM PËRQASËS)

Meshari, ky ekzemplar i rrallë që dëshmon për fillimet e historishkrimit në gjuhën shqipe dhe i zbuluar për herë të parë shumë kohë pasi u shkrua dhe u botua¹, u bë objekt studimi për vite të tëra nga studiues shqiptarë dhe të huaj, duke u analizuar në mjaft aspekte të përmbajtjes, tipareve tekstologjike-gjuhësore dhe të rrethanave historike në të cilat mendohet të jetë mundur realizimi i botimit të tij.

Që nga rizbulimi në fillim të shekullit të kaluar të këtij libri nga P. Skiroi dhe më tej nuk kanë munguar përpjekjet për ta transkribuar dhe për ta nxjerrë në dritë *monumentin ma të vjetrin të njohur të gjuhës dhe letratyrës shqipe*².

¹ Petrotta G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, 1931, f.64: Questo è l'antichissimo *Messale Albanese per antichità tutto stracciato* che S.E. l'Arcivescovo di Scopia Monsignor Don Giovanni Battista di Nicola Casasi, Albanese di Giacova, verso l'anno 1740 aveva con meraviglia visto a Roma nel Collegio di Propaganda. Volle da esso trascrivere di proprio pugno un esemplare dell'ultima pagina, lieto di mandarlo in dono all'inclito P.Giorgio Guzzetta, fondatore del Seminario Albanese in Palermo e di altri Istituti albanesi, prototipo delli spiriti magnanimi e dell'animo e della generosità della nazione Albanese; Çabej E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006, f.9: Zbulimi i parë i këtij libri i detyrohet D.Nikollë Kazazit prej Gjakove, kryepeshkop i Shkupit, në vitin 1740. Ky kopjoi një copë të këtij "antichissimo *Missale per antichità tutto stracciato*" dhe ia dërgoi si peng nderimi atë Gjergj Guzetës, themeluesit të Seminarit arbëresh të Palermos. Me kohë ndërkaq veprës përsëri iu tretën gjurmët.

² Çabej E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006, f.9: Qëkur Pal Skiroi, dikur peshkop i Bendës dhe drejtor i Seminarit arbëresh të Palermos, njoftoi (më 1910) qarqet e interesuara për ekzistencën e një monumenti të madh të gjuhës shqipe që mbante emrin e Dom Gjon Buzukut e që e pat gjetur ai në Bibliotekën Vatikane, një varg dijetarësh, të huaj e shqiptarë, iu afrua kësaj vepre gjer sot më të vjetër të literaturës shqiptare dhe është përpjekur të zgjidhë disa nga problemet që shtrën kjo vepër, e disave prej tyre u dha edhe zgjidhje.

Çështja e tejshkrimit të teksteve të kësaj veprë pa dyshim paraqiste vështirësi serioze para studiuesve që ndërmorën një ndërmarrje të tillë. Në këto raste nevojitet zotërimi kompetent i njohurive jo vetëm në fushë të zbërthimit të shenjave të caktuara grafike të pranishme në tekstet e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe, por edhe i përmbajtjes dhe i renditjes së teksteve të caktuara liturgjike, që gjenden përkatësisht në përbërje ritualesh, breviarësh apo mesharësh romanë.

Në traditën e studimeve buzukiane njihen e vlerësohen dy botime të plota kritike të realizuara përkatësisht nga Namik Ressuli (Romë, 1958)³ dhe Eqrem Çabej (Tiranë, 1968)⁴. Bëhet fjalë për botime serioze që u shërbejnë studiuesve si burime të rëndësishme referimi për studimin e thelluar të librit të parë në gjuhën shqipe.

Të një rëndësie të veçantë mbeten gjithashtu studime kritike mbi veprën e këtij autori dhe që përmbajnë trajtime çështjesh themelore e shtjellime argumentesh të natyrës fonologjike, filologjike-tekstologjike, si dhe deskriptive-analitike mbi vendin, kohën e rrethanat historike të botimit të librit.

I tillë mbetet studimi monumental i M.Camaj me titull *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, botuar në Romë në vitin 1960 në përmasat e një *opuskoli*, me anë të të cilit autori i dha rrugë sqarimit të mjaft çështjeve kyçe që lidhen me të parin libër të shkruar që njihet deri më sot nga tradita e studimeve në fushë të historisë së letërsisë së shkruar shqipe.

Camaj shquhet për një metodologji të veçantë dhe origjinale pune me *Mesharin*. Edhe mënyra e artikulimit të veprës së tij në paragrafe e kapituj të veçantë dëshmon për ndërgjegjshmërinë e tij në lidhje me rëndësinë e trajtimit të çështjeve themelore që shtron studimi i librit të Buzukut. Ai ka trajtuar një sërë problemesh në pikëpamje të disa nënsistemeve gjuhësore. Në veprën e tij bëhet objekt diskutimi vendi i mundshëm ku mund të jetë botuar vepra së bashku me hipotezat e bëra *ad hoc* nga studiues si Roques⁵,

³ Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.

⁴ Meshari i Gjon Buzukut (1555), botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, *Pjesa e parë dhe e dytë*, Tiranë, 1968.

⁵ Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Roma 1960, *Introduzione*, f.8: Anche circa il posto della pubblicazione si è argumentato moltissimo, piuttosto per ipotesi, senza sufficienti documentazioni. M.Roques (*Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932) pensa che sia stampato a Venezia come tutti i testi sacri croati e in parte

Çabej etj.; interpretimi i shenjave të caktuara grafike⁶, ndikimi i Buzukut nga tekste ekzistuese paralele, dallimi i argumentuar dhe skrupoloz i elementeve të huaja latine, sllave, venete, italiane, greke në tekstet e librit, ndikimi në nënsisteme të caktuara si sintaksa e fjalisë, e periudhës, përqasja me autorë të tjerë pasardhës të Buzukut dhe me poezinë epike popullore.

Studiuesi Selman Riza i ka kushtuar gjithashtu librit të Buzukut një pjesë të konsiderueshme të studimeve të tij mbi historinë e gjuhës shqipe. Libri i parë në gjuhën shqipe bëhet objekt studimi nga ana e tij jo vetëm në trajtime të posaçme mbi autorët e vjetër të letërsisë shqipe, por citohet me anë shembujsh edhe në studime të morfologjisë historike mbi problemet e sistemit rasor emëror dhe përemëror të shqipes, nyjave etj. Riza analizon dhe gjykon deri në detaje jo vetëm tiparet e gjuhës së Buzukut, por edhe qëndrimet apo interpretimet e studiuesve ndaj problemeve të rëndësishme, siç janë ekzistenca apo njohja e deritanishme e një ekzemplari të vetëm të gjendur gjithsesi në një prej bibliotekave më të rëndësishme në botë, rrethanat në të cilat mund të jetë botuar libri, emërtesat më të përshtatshme që mund t'i jenë atribuar nga këta studiues etj. Pikërisht në lidhje me emërtimin më të përshtatshëm të veprës Riza ka dhënë interpretime objektive duke gjykuar jo vetëm mbi vlerësimet *ad hoc* të bëra nga studiues të mëparshëm si Rrota, Roques etj., por edhe duke pasur parasysh se një emërtim adekuat i jepet librit vetëm duke konsideruar objektivisht raportin përpjesëtimor midis teksteve të përmbajtura në të: *Rituali, Breviari, Meshari*.⁷

serbi dell'epoca. La tesi del Roques ultimamente è stata accettata anche dallo studioso albanese E.Çabej. Lo scienziato francese porta come argomento anche il risultato dello studio fatto sulle filigrane della carta per scoprirne la provenienza: "Le papier don't on s'est servi est italien: Briquet nous le montre employé en Italie au XVI siècle, à Naple et Syracuse, à Vicence et Treviso". Roques, trattando delle filigrane, dice: "Dans le corps du volume on trouve en écusson (fol.xliij, xliij), mais surtout (f.92, 95) la sirène à double queue courbée et redressée, enfermée dans un cercle, telle qu'on en trouve des exemples dans Briquet (IV, p.685, n.13880-895).

⁶ Camaj M., *vep. e cituar, Kapitulli i parë (Ortografia)*, f.11 v.

⁷ Duhet pasur parasysh në lidhje me këtë argument dhe shtjellimi nga ana e Rizës e strukturimit të veprës së Buzukut. Në veçanti për strukturimin e veprës së Buzukut duhet parë Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.403: Në "veprën" e Buzukut prej 110 fletësh (nga të cilat në ekzemplarën ekzistues janë ruajtur vetëm 94 fletë) përfaqësohen tri veprat fetare të ndryshme e pikërisht: *Breviari*, që zinte 20 fletët e

Riza është thellësisht i vëmendshëm ndaj librit të Buzukut. Kriticiteti dhe objektiviteti i tij shprehen në veçanti në analizat gjuhësore të teksteve të librit, në interpretimet e raportit të tekstit buzukian me atë të *Vulgatës* latine, në drejtim të dallimit të formave të veçanta që mund të mos kenë prejardhje latine, por venete apo italiane. Jo rrallë jemi ndeshur me shënime të këtij studiuesi që sqarojnë ekuivoke të mundshme në përmbajtjen e teksteve apo ndikime të tepruara nga sintaksa e fjalisë latine.

Ndikimin nga latinishtja në strukturat sintaksore në gjuhën e Buzukut në rang sintagme dhe periudhe Camaj e ka trajtuar në një kapitull të veçantë të veprës së tij, të titulluar pikërisht *Influssi stranieri nella lingua del "Messale"*⁸. Ky ndikim trajtohet në një syth më vete në kapitullin e sipërpërmendur dhe pasi autori ka analizuar ndikimin dhe kalkimin e terminologjisë kishtarë në gjuhën e Buzukut. Riza gjithashtu trajton këtë çështje duke cituar në mjaft raste edhe ndërtime sintaksore që dëshmojnë për ndikim të tepruar nga latinishtja⁹.

para 9nga të cilat në ekzemplarën ekzistues mungojnë fletët I-VIII); *Rituali*, që zinte 9 fletët pasuese (nga të cilat në ekzemplarën ekzistues mungojnë fletët XXVII-XXIX); *Meshari*, që zinte 81 fletët e fundit (nga të cilat në ekzemplarën ekzistues mungojnë fletët XXXIII-XXXVI dhe fleta bis LXIII). Pra, në "veprën" e Buzukut breviari dhe rituali zinin afro një të katërtën e fletëve, kurse meshari afro tri të katërtat.

Ndërsa në lidhje me librin e Buzukut Camaj ka përdorur emërtesën *Meshar*. Përdorimi i këtij emërtimi bëhet më tepër në kushtet e domosdoshmërisë së gjetjes së një termi të përshtatshëm për ta përmendur a cituar atë në kushtet e trajtimit të problemeve të ndryshme. Që në hyrje të veprës së tij ai përdor emërtesën *Meshar* (it. *Messale*) duke passur parasysh se që D. N. Kazazi që e quajti kështu për herë të parë atë dhe se studiues të tjerë mund ta përdorin sërish atë, meqë përmban në një masë të konsiderueshme tekste nga *Meshari* roman.

⁸ Shih Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Roma 1960, f.55.

⁹ Ndër të tjera citojmë dhe interpretimin nga ana e Rizës të ndërtimit buzukian "*ish zanë n etheshit së mëdhāsh*", në Riza S., *Vepra* 4, Prishtinë, 2004, f.430, interpretuar si kopjim i sintaksës latine: *tenebatur magnis febribus*; *e kishnë zanë ethe të mëdha*; ndërtimin *u harruo n vetëvetëhej*, me kuptimin *harroi vetvëveten*, interpretuar gjithashtu si kalk sintaktik nga latinishtja (*po aty*, f.439), etj. Për ndikim nga sintaksa latine Riza flet edhe në lidhje me përdorimet e rasave të zhdrejta nga Buzuku. Kështu edhe në lidhje me përdorimin buzukian *u haruo n meje*, Riza (*Vepra* 4, botim i cituar, f.454) shprehet: *..ndonëse në latinishte*

Të dy këta studiues kanë bërë objekt studimi analizën tekstologjike të veprës, për të arritur kështu në mjaft konkluzione që ndriçojnë aspekte të morfologjisë historike të shqipes, të diferencimit të dukshëm gjuhësor të pjesëve të caktuara, siç janë lutjet¹⁰ dhe fragmentet nga *Ungjijtë*. Ky fakt i fundit si dhe çështja e konceptimit të pjesëve përbërëse të veprës i bashkon studiuesit tanë buzukianë. Riza jo vetëm diferencon gjuhën e lutjeve të veprës, por konstaton gjithashtu edhe vështirësi serioze në mundësinë e zbërthimit apo interpretimit të ndërtimit sintaksor të fjalisë apo përmbajtjes së këtyre teksteve të shkurtra që shoqërojnë shpesh tekstet biblike të librit. Në lidhje me këtë argument Camaj thekson gjithashtu diversitetin e dukshëm midis gjuhës së pjesëve përkatëse dhe dedukton në faktin se një pjesë e tyre mund të jenë përkthyer për herë të parë nga Buzuku¹¹.

Vlerësimi i rolit të rëndësishëm që duhet të ketë pasur në punën me librin *Vulgata latine*¹² mbetet një argument me interes për të cilin janë shprehur të dy studiuesit tanë. Camaj shprehet për këtë argument në kapitullin e katërt të veprës së tij:

Natyrisht tekstet sllave nuk kanë për përkthyesin shqiptar (e këtu bëhet fjalë pikërisht për Buzukun) autoritetin e origjinalit latin, por shërbejnë si objekt konsultimi në punën e vështirë të përkthimit apo të përshtatjes. Në fund të fundit edhe sot e kësaj dite kush përkthen Ungjillin ose çfarëdo lloj

përdoret jo rrjedhërisht, por gjinorisht: "miserere mei", prapëseprapë edhe këtu kemi ndikim nga sintaksa latine): "ki mëshirë për mua".

¹⁰ Në lidhje me lutjet e librit të Buzukut, të para në pikëpamje të tipareve gjuhësore të tyre dhe në raport përpjesëtimor me pjesën tjetër të teksteve buzukiane, shih Riza S., *Vepra* 4, Prishtinë, 2004, f.403.

¹¹ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960, f.31: *Come si è già notato, molti brani del Vangelo e del Vecchio Testamento, eccettuando qualche salmo, differiscono in lingua e stile in primo luogo dalle preghiere di tutta l'opera e poi dagli Uffici e dal Rituale cum catechesi. Difatti le preghiere del "Messale" risentono molto dell'influsso del testo latino sia nel lessico, sia nella costruzione, così che assomigliano più a un primo abbozzo che a una vera e propria traduzione.*

¹² Camaj nuk përjashton mundësinë e konsultimit nga ana e Buzukut të leksionarëve apo Mesharëve të përshtatur në gjuhë popullore sllave. Ky problem trajtohet mjaft gjerësisht pikërisht në kapitullin *Influssi stranieri nella lingua del Messale*, f.54 v. Siç dihet, Camaj ka radhitur elementet nga gjuhët e huaja duke respektuar një lloj renditjeje: elemente latine, sllave, venete, greke.

vepre klasike konsulton përkthime në gjuhë të tjera në mënyrë që të zgjidhë vështirësi eventuale teknike¹³.

Raporti përkatës i tekstit buzukian me atë latin trajtohet edhe nga Riza. Ai shprehet:

*Krahasimi i përkthimit të Buzukut me origjinalin latin është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për çdo studim filologjik të mvehtësishëm të tekstit të Buzukut*¹⁴.

Çështja e raportimit të drejtë dhe të duhur të tekstit buzukian me atë të *Vulgatës* latine apo të tjera tekste në gjuhë të tjera duhet marrë në konsideratë çdo herë që merren në shqyrtim pjesët nga *Dhiata e vjetër* apo fragmentet nga *Ungjijtë*. E kjo duke pasur parasysh faktin që Buzuku do t'i vinte këto pjesë a fragmente në përbërje të një *Meshari*, me shprehjet tipike hyrëse që introdukojnë leximin e pjesëve të caktuara biblike krahas lutjeve që u prijnë apo i ndjekin këto tekste. Këto fakte të rëndësishme që ndihmojnë në kuptimin e drejtë të tipareve tekstologjike të librit të parë në gjuhën shqipe janë trajtuar me të drejtë si parësore edhe në studimet e Justin Rrotës dhe Eqrem Çabejt¹⁵. E në këtë pikëpamje kontribuojnë në mënyrë të veçantë edhe Camaj e Riza: Camaj duke përqasur tekste të ngjashme mes tyre të Buzuku e duke dalluar ndryshimet në përdorime të caktuara në pikëpamje të përkthimit të tyre¹⁶, duke bërë në raste të caktuara edhe qasje me tekste të këngëve popullore epike në gegërishte; Riza duke marrë në veçanti tekste të tëra e duke i analizuar me hollësi në pikëpamje

¹³ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shënjzat, Romë, 1960, f. 66: *Naturalmente i testi slavi non hanno per il traduttore (e qui penso si tratti proprio del Buzuku) l'autorità dell'originale latino, ma servono come oggetto di consultazione nel difficile lavoro di traduzione e di adattamento. Del resto anche oggi è in uso di chi traduce il Vangelo o qualsiasi opera classica di servirsi di traduzioni in altre lingue per risolvere le eventuali difficoltà tecniche.*

¹⁴ Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.404.

¹⁵ Çabej E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.

¹⁶ Shih Camaj M., *vep. e cit.*, f.36-41, në lidhje me përqasjen e përkthimit të së njëjtës pjesë biblike nga *Ungjilli sipas Lukës*, të përmbajtura përkatësisht në *Oficen e Zojës* dhe në *Meshar*. Në këtë pjesë të veprës njihemi me analiza të hollësishme gjuhësore të teksteve të përqasura dhe me shprehjen e një pikëpamjeje të rëndësishme mbi autorësinë e tyre. Camaj shprehet pikërisht se ndryshimet themelore që vihen re në analizën e teksteve të mësipërme çojnë në mendimin se këto pjesë mund të mos i ketë përkthyer e njëjta dorë.

të aspekteve formale dhe kuptimore fjalëformat e ndryshme që përmbahen në këto tekste¹⁷.

Siç u theksua edhe në hyrje të kësaj paraqitjeje, kontributi i albanologëve në lidhje me librin e parë në gjuhën shqipe, i shprehur herë me përpjekje për të përshtatur e tejshkruar pjesë të tëra të përmbajtura në të, herë me studime të thelluara, ka shërbyer për të themeluar një traditë të shëndoshë të studimeve buzukiane. Në këtë plejadë studiuesish renditen me plot të drejtë dy studiues të shquar në fushë të kërkimeve albanologjike: Martin Camaj, shkrimtar, albanolog dhe Selman Riza, studiues i spikatur i historisë së shqipes së shkruar.

BIBLIOGRAFI

- Buzuku Gj., *Meshari, I,II, (botim kritik përg. nga E.Çabej)*, Tiranë, 1968.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.
- Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n.3, 1963.
- Çabej E., *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Çabej E., *Studime shqiptare, Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Demiraj Sh., *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
- Demiraj Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986.
- Petrota G., *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931.
- Riza S., *Nyjet e shqipes*, BUSHT, SShSh, n.4, 1958.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe (krestomati thjesht gjuhësore)*, Tiranë, 1961.
- Riza S., *Probleme të nyjeve të shqipes*, SF n.1, 1982.
- Riza S., *Vepra 3*, Prishtinë, 2002.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, botime Toena, Tiranë, 2002.
- Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004.
- Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp (dhe studime tjera gjuhesore)*, Botimi II, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.

¹⁷ Shih për këtë argument Riza S., *Vepra 4*, Prishtinë, 2004, f.408-478. Në analizat e tekstit që përmbahen në këtë vepër të Rizës bëhet shpesh përqasja me tekstin latin gjegjës. Në këto raste Riza përdor termin "*originali latin*".

